

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DUXAL" SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 13 Shtator 2023 (dymijë e njezet e tre) personat e mëposhtem:

1. Z. Saimir TOPOLLARI, atësia Sokol, i datëlindjes 09.10.1982, lindur Gramsh dhe banues ne Tirane, Farke, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr personal ID I21009114F

2. Z. Gramos MEMISHAJ, atesia Petrit, i datelindjes 21.06.1969, i lindur dhe banues në Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal G906210560

Në cilësinë e "Ortakeve Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire pivate, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**Duxal**" SHPK.

Shoqeria do te kete emer tregtare '**Duxal**'

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1
Emri dhe Ortaket**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin "**DUXAL**" SHPK.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria "**Duxal**" SHPK ka si objekt të veprimtarise te saj, zhvillimin e aktiviteteve si me poshte"

Import-Eksport, shitje me shumice dhe pakice te mallrave dhe produkteve industrial, veshje te te gjitha llojeve, mallra dhe pajisje te ndryshme. Shoqeria mund te kryeje ne Shqiperi dhe jashte shtetit te gjitha operacionet komerciale, industriale dhe financiare, te tundshme dhe te patundshme te shoqerive te tjera.

Gjithashtu shoqëria mund te ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 3
Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumit përkatës vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria "Duxal" SHPK gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKR-se.

Neni 4
Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: **TIRANE Rruga Sami Frasheri, Zona Kadastrale Nr. 8270, numer pasurie Nr.7/630-N11**
- 4.2 Gjate veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë dege, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

KREU III

Neni 5
Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **10.000.000 Lek** (Dy milion lek), i barabartë me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakëve përbejnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlerë nominale të kuotës së secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Emri i Ortakëve	Kuota	Kontributi i ortakëve në kapital (leke)	Përqindja në kapital
1.	Saimir Topollari	1	5,500,000.	55%
2.	Gramos Memishaj	1	4,500,000.	45%
Totali		2	10,000,000.	100 %

- 5.3 Kontributet sa më sipër do të shlyhen në periudhat e mëvonshme.

Neni 6
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën

e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëvenë përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqërite Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndermjet paleve.
- 7.2** Transferimi i kuotave te ortakeve te shoqerise brenda ortakerise apo ne drejtim te personave te trete jashte ortakerise eshte i kushtezuar ne cdo rast nga miratimi i asamblese se pergjithshme te ortakeve sipas kuorumit te nevojshem te percaktuar me poshte.

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3** Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Kreu IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
- m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

- 9.2 Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkrese, me postë ose e - mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithë ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4 Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithë Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te ditës, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10




Kuorumi i nevojshem

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 50 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve vendos me 3/4 të ortakëve zoterues të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si:
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4 Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshte të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.



11.5 Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 12

Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakeve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "**Duxal**" SHPK: **Z. Saimir TOPOLLARI**, atësia Sokol, i datëlindjes 09.10.1982, lindur Gramsh dhe banues në Tiranë, Farke, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr personal ID I21009114F per nje afat 5 vjecare, nga momenti i regjistrimit te ketij akti prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të vecantë, Administratori ka këto kompetenca:
- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përsa i përket administrimit të zakonshëm;
 - (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
 - (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
 - (iv) do të përgatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipoteke, peng

- apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijoje nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
- (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise - duke nenshkuar dokumentet / instrumentet e pagesave;
 - (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
 - (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
 - (viii) do te krijoje nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
 - (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
 - (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
 - (xi) do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
 - (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
 - (xii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e pergjithshme, ne baze te njeh vendimi te marre me shumicen e percaktuar sa me siper, ka te drejte te ngrejeh padi perpara gjykatesh kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratorëve, si pasojeh e shkeljes se rendeh te ligjit ose te statutit dhe/ose padi te tjera qeh parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15 **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte meh Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikesh 6 te nenit 95 te Ligjit;
2. personi vuan ose mund te vuajeh nga crregullime mendore;
3. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-afetise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;

6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në baze të kuorumit të kërkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykatë; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

Neni 18

Njoftimet

- 18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e

parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin. Administratori është i detyruar të administrojë të dhenat e ortakeve (nr.tel, email, adrese banimi etj) në një regjister të posacem dhe ortaket janë të detyruar të njoftojnë gjithmone administratorin për çdo azhurnim të ketyre të dhenave brenda dites, në të kundërt mbajnë përgjegjësi për demin e shkaktuar.

- 18.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

Neni 19

Te Ndryshme

- 19.1 Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 19.2 Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4 Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilët i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5 Për të gjitha ceshtjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

NENI 20

Dispozita përfundimtare


- 20.1 Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve sipas shumicës së cilesuar të percaktuar me sipër.
- 20.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortaket do të referohen legjisllacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga palet pa asnjë rezervë.

ORTAKET THEMELUES

Saimir Topollari

Saimir Topollari



Gramos Memishaj

Gramos Memishaj

